



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:140795

Datë: 08.07.2021

Numri i dokumentit: 01971820

**P. nr.333/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Ilirjana Hoti dhe me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit E. H. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të kanosje nga neni 181 par. 2 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti-Përgjithshëm në Gjakovë, PP/II.nr. 743/21 të datës. 30.06.2021, duke vendosur në lidhje me propozimin e PTHDP-Gjakovë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me dt.08.07.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e PTH-DP në Gjakovë PP/II.nr. 743/21 dt. 30.06.2021, dhe kjo Gjykatë, jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

Të akuzuarit:

**E. H.**, nga i ati A., dhe nëna H. e gjinisë S., data e lindjes . . . , në Gjakovë ku edhe banon në rr.”. . .”, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtorë, me nr.personal: . . . , shqiptar, Shtetas i R. Kosovës,.

**Ë s h t ë f a j t o r**

**Sepse :**

**-me datë 24.04.2021** ,seriozisht kanos personin tjetër me fjalë vepra apo gjeste se do ti shkaktojë të keqe me qëllim frikësimi apo shkaktimi të ankthit te personi i tillë, në atë mënyrë që ditën kritike rreth orës 17:20min në bisede e sipër përmes telefonit te zhvilluar nga e dëmtuara H. H. me të pandehurin rreth një problemi të ndarjes se vajzës se saj me djalin e hallës së të pandehurit, e pa kënaqur në atë mënyrë e dëmtuara i kërkon të njëjtit që të ia sigurojë numrin e telefonit të nënës së tij e poashtu edhe M., ashtu që pasi e njëjta kishte nevojë për të sqaruar problemet pse i ishte ndarë vajza nga burri M. T. në Suedi dhe se duke kërkuar kështu nga i pandehuri pasi që ai dhe motra e tij E. kishte qenë ajo që i kishte njoftuar si çift dhe i pandehuri duke mos dashur që të përzihet në këtë punë pas 3 vite martesë të atyre si çift e po ashtu as motra e tij dhe pasi e dëmtuara H. nuk i ndalet së kërkuari për të kontaktuar me nënën apo M. se përndryshe do ti shkojë tek motra E. në shtëpinë e saj në . . . , atëherë i pandehuri E. në përgjigje e sipër e kanos përmes telefonit me fjalët: *“me shku n’shpi n’ . . . te motra, kujtoni mirë se ka me marrë vesh krejt Gjakova, keni me marrë vesh kush është E. H.”*, *“shkoni në . . . , e më thotë*

*motra a vllavi i jam se kanë ardhë H. në . . . kqyr se 24 vjet i kam, po plumi ka me kan për ty”, për çka e dëmtuara i është përgjigjur “ishalla pshtojmë, ishalla pshtojmë”, me çka në këtë mënyrë i pandehuri tek e dëmtuara H. dhe familja e saj me veprimet e tij ka shkaktuar ankth, shqetësim dhe pasiguri për jetën dhe trupin e tyre nga fjalët kanosëse.*

**- me çka ka kryer veprën kanosje nga neni 181 prg.2 të KPRK-së.**

Andaj, Gjykata konform nenit 4,17,38,40, 43,69 dhe nenit 181 par.2 të KPRK-së, si dhe nenit 495 te KPPK-së, të akuzuarin E. H. e

## **G J Y K O N**

Me dënimin me gjobë në shumë prej **200 (dyqind) euro**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pas plotfuqishmërisë, së këtij Aktgjykimi -Urdhër ndëshkimor, në kërcënim të përmbarimit me dhunë .

I dëmtuari H. H. nga Gjakova , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Nëse, dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 43 par.4 të KPRK-së, atëherë i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **10(dhjet) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20,00 € (njëzet) euro**.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30,00 €**, si dhe në emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumën prej **20,00 €** , në afat prej **15 ditëve**, pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

## **A r s y e t i m**

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngrit Aktakuzën PP./II nr. 743/21 të dt. 30.06.2021 , ndaj të akuzuarit E. H. nga Gjakova, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par. 2 të KPRK-së.

Komfor nenit 493 te KPPK-së, PTH në Gjakovë, kësaj Gjykate i ka propozuar që ndaj të akuzuarit të lartcekur, pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të nxjerr urdhër ndëshkimor dhe të njëjtit t’i shqiptohet dënimi me gjobë.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t’i referohet dispozitës së nenit 181 par. 2 të KPRK-së e cila dispozitë për kryesit e kësaj vepre penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim deri në 1(një) vit.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 te KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-se dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH-së në Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të shqiptoj ndaj të akuzuarit, dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit .

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- Kallëzimi penal me nr. të rastit 2021-EA-556 dt. 11.05.2021
- Deklarata e të pandehurit E. H. të dhënë në polici me dt.24.04.2021;
- Deklarata e të dëmtuarës H. H. të dhënë në polici me dt.24.04.2021;
- Raporti fillestar i incidentit të dt.24.04.2021;
- Raporti i shpejtë i dt.24.04.2021;
- Raporti i policit I. Gj. #10306i dt.18.03.2021;
- CD-ja;
- Foto dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë.

Shkresat e lëndës janë prova të mjaftueshme me të cilat argumentohet se i akuzuari është kryes i veprës penale për të cilën akuzohet.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtit do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 38 të KPRK-së në mënyrë që të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 €, është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej nga 30.00 € është marr konform nenit 39 par.3 nën.par.3.1 të Ligjit Nr. 05/L-036. për kompensimin e Viktimave të Krimit .

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**P.nr. 333/21 të dt. 08.07.2021**

**Sekretarja Juridike:**  
**Flutur Nagavci**

**Gjyqtarja**  
**Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej **8ditësh**, nga dita e marrjes së të njëjtës ,Gjyqtare të kësaj Gjykate . Nëse i pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merr formë të prerë.

Numri i lëndës: 2021:140795  
Datë: 08.07.2021  
Numri i dokumentit: 01971820